



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2021:281979

Datë: 04.04.2024

Numri i dokumentit: 05546560

Kom.Dh.Shk.II.nr.1014/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Dren Rogova, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “Durimi” shpk, me numër unik identifikues 810254673, me seli ne Vasilevë-Glllogoc, kundër debitorit “BK Construction” shpk, me numër unik identifikues 410746589, me seli ne Pejë rr.”Zhuj Selmani”, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1397/22 të datës 30.05.2023, me datë 04.04.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit “Durimi” shpk, me numër unik identifikues 810254673, me seli ne Vasilevë-Glllogoc, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1397/22 të datës 30.05.2023, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1397/22 të datës 30.05.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “BK Construction” shpk, me numër unik identifikues 410746589, me seli ne Pejë rr.”Zhuj Selmani” dhe e ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.719/21 dt.22.11.2021, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi me seli ne Gjakovë.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak shkeljes se dispozitave te procedurës përmbartimore dhe kontestimore si dhe konstatimit te gabuar apo jo te plote te gjendjes faktike, me propozim qe aktvendimi i atakuar te ndryshohet dhe urdhri përmbartimore te mbetet ne fuqi.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori "Durimi" shpk, me numër unik identifikues 810254673, me seli ne Vasilevë-Gllogoc, me datën 22.11.2021 ka paraqitur propozim për lejimin e përmbarimit, kundër debitorit "BK Construction" shpk, me numër unik identifikues 410746589, me seli ne Pejë rr."Zhuji Selmani", në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturave nr. 20-SHV01-001-115, nr.20-SHV01-001-146, nr.20-SHV01-001-197, nr.20-SHV01-001-230, nr.20-SHV01-001-11. Përmbaruesi Privat Gjokë Radi, me seli në Gjakovë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka caktuar urdhrin P.nr.719/21 dt.22.11.2021, duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që t'ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave shumë prej 11,040.00€ me kamatë prej 8% vjetore si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kundër urdhrin përmbarimor debitori ka ushtruar prapësim me datën 07.12.2021, me arsyetimin se nuk ka asnjë obligim ndaj kreditorit, adresa e debitorit operon ne adresën e njëjtë dhe se nuk kanë pranuar asnjë lende nga ana e postes, andaj kërkon qe faturat e kreditorit te deklarohen pa efekt.

Përgjigje ne prapësimin debitorit ka ushtruar kreditori me datën 10.12.2021, me arsyetimin se pretendimet debitorit janë krejtësisht te pabazuara, shton se faturat janë dorëzuar përmes emailit te cilat i ka pranuar debitori pa asnjë kontestim propozon qe gjykata ta obligoj debitorin ta përmbush obligimin ndaj kreditorit dhe ta paguaj normën e interesit prej 0.8% vjetore si dhe shpenzimet procedurale.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr1397/22 dt.30.05.2023, me të cilin e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe e ka anuluar urdhrin përmbarimor. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se në rastin konkret Faturat nr. 20-SHV01-001-115, nr.20-SHV01-001-146, nr.20-SHV01-001-197, nr.20-SHV01-001-230, nr.20-SHV01-001-11, në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotësojnë kushtet ligjore për te qenë dokumente te besueshme sepse nuk mund te vërtetohet se janë pranuar ne mënyrë te rregullt nga debitori, duke qenë se nuk përmbajnë nënshkrimin apo vulën e debitorit, ndërsa nga shkresat ne lëndë nuk mund te gjendet ndonjë provë tjetër përmes se cilës mund te vërtetohej se faturat janë dorëzuar me rregull dhe janë pranuar nga debitori se bashku me detyrimet qe rrjedhin nga këto fatura. Pretendimet e kreditorit se faturat janë dorëzuar përmes komunikimit elektronik dhe se te njëjtat nuk janë kundërshtuar nga debitori gjykata i vlerësoj si te paqëndrueshme sepse ne komunikimet elektronike nuk mund te vërtetohet se cilat dokumente i janë dërguar debitorit pasi mungon përshkimi i saktë i faturave ndërsa ne asnjërën prej komunikimeve nuk ka konfirmime te pranimit te faturave nga ana e debitorit se bashku me detyrimet qe rrjedhin nga këto fatura, andaj edhe ka vendosur si ne dispozitiv te aktvendimit.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbareme me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar se faturat e lëshuara nga ana e kreditorit nuk përmbajnë nënshkrim nga debitori, e as vulën e debitorit. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet ligjore nga Neni 29 par.3 i LPP, i cili përcakton se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se dhomat e shkallës së parë kanë konstatuar drejtë se faturat si dokument i besueshëm mbi të cilat ishte iniciuar procedura përmbareme, respektivisht është lejuar përmbarimi nuk i plotësojnë kushtet në mënyrë kumulative që duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se faturat nuk e përmbajnë nënshkrimin e pranuesit i cili është kusht esencial mbi bazën e së cilës dokumenti i besueshëm fiton tipare të përmbarueshmërisë së titullit ekzekutiv, mbi bazën e së cilës mund të konstatohet ekzistimi i detyrimit dhe pranimi si i tillë nga debitori. Së këndejmi, Gjykata thekson se pa plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm nuk mund ta ketë fuqinë e titullit përmbarues sepse rezulton se debitori nuk e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbareme duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbareme të iniciohet përmes këtyre dokumenteve.

Kjo gjykate i analizoj pretendimet e kreditorit se faturat janë dërguar përmes emailit dhe te njëjtat nuk janë kontestuar, por i vlerëson si të paqëndrueshme sepse nga shkresat në lëndë nuk mund të gjendet ndonjë provë tjetër përmes së cilës mund të vërtetohet se faturat janë dorëzuar me rregull dhe janë pranuar nga debitori dhe se nga komunikimet elektronike nuk mund të vërtetohet se cilat dokumente i janë dërguar debitorit pasi mungon përshkrimi i saktë i faturave ndërsa në asnjërin prej komunikimeve nuk ka konfirmime të pranimi të faturave nga ana e debitorit.

Përndryshe, në procedurën përmbareme konform parimit të rigorozitetit formal, bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e Organit Përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhoma e Shkalles së Dytë  
K.DH.SH.II nr.1014/23, me datë 04.04.2024

Gjyqtari,  
Dren Rogova